NEWSLETTER

TETOR 2026

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Kontributi i UBT-së mbi rezistencën antimikrobike dhe qasjen "Një Shëndet"

Një hap i rëndësishëm për më shumë praktika, mundësi dhe orientim për studentët, por edhe për forcimin e bashkëpunimit akademik e shkencor në funksion të zhvillimit të bujqësisë shqiptare.

Lexo në faqen 4

UBT nis vitin e ri akademik 2026–2027

Në një ceremoni zyrtare mirëseardhjeje, në sallën "Behar Male" të mbushur plot me studentë, Universiteti Bujqësor i Tiranës çeli zyrtarisht vitin e ri akademik 2026–2027

Një mesazh i veçantë për studentët erdhi nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku. Ceremoninë e përshëndeti edhe Fatmir Guri, Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili theksoi mundësitë që ofrojnë bujqësia dhe zhvillimi rural. Emocionet e fillimit të rrugëtimit universitar u përcollën nga Isel Telha, student i vitit të parë, i cili ndau pritshmëritë e tij për këtë etapë të re.Mesazhe frymëzuese sollën edhe dy alumni të UBT-së, Joana Bano, Kryetare e Shoqatës së Agroturizmit, dhe Sandër Xhambazi, sipërmarrës. **Vijon**...

Mirësevini të dashur studentë!

Universiteti Bujqësor i Tiranës çeli zyrtarisht vitin e ri akademik 2026–2027. Një mesazh i veçantë për studentët erdhi nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, i cili i ftoi të rinjtë ta shohin universitetin jo vetëm si vendin ku do të marrin një diplomë, por si hapësirën ku do të ndërtojnë veten dhe të ardhmen e tyre. “Besoni. Përpiquni. Krijoni. Besoni te vetja. Përpiquni edhe kur rruga bëhet e vështirë. Dhe krijoni diçka që është më e madhe se vetja juaj”, ishte mesazhi i Rektorit Sallaku për studentët në nisje të këtij rrugëtimi.

Ceremoninë e përshëndeti edhe Fatmir Guri, Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili u ndal te mundësitë që ofrojnë sot sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural për të rinjtë.

Një nga momentet më të veçanta ishte fjala e Isel Telhës, student i vitit të parë, i cili solli në sallë emocionin dhe pritshmëritë e një të riu që sapo nis rrugëtimin universitar.
Një mesazh i veçantë erdhi edhe nga dy alumni të UBT-së, Joana Bano, Kryetare e Shoqatës së Agroturizmit, dhe Sandër Xhambazi, sipërmarrës i Veza Savio. Përmes historive të tyre, ata u treguan studentëve se rrugëtimi që nis në auditorët e UBT-së mund të shndërrohet më pas në mundësi konkrete profesionale dhe sipërmarrëse.

Në një vit të veçantë, kur UBT shënon 75 vite histori, një brez i ri studentësh nis të shkruajë kapitullin e tij.

Lexo më shumë...

Reforma e UBT-së tërheq vëmendjen ndërkombëtare

Transformimi akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës ka tërhequr vëmendjen edhe të medias italiane Corriere Italico, e cila i ka kushtuar një artikull procesit të reformimit të universitetit dhe vizionit për një institucion më modern, europian dhe të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes. Reforma, e zhvilluar në bashkëpunim me BOKU University në Vjenë, synon modernizimin e programeve të studimit dhe përafrimin me standardet europiane.

Krahas vëmendjes ndërkombëtare, UBT ka shënuar rritje të interesit të studentëve, me regjistrime në disa programe Bachelor mbi 20–30% krahasuar me vitin e kaluar, si dhe nivele të larta regjistrimesh në programet Master. Rektori, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, i ka vlerësuar këto rezultate si dëshmi të besimit në rritje të studentëve dhe familjeve shqiptare.

Në vitin e 75-vjetorit të themelimit, UBT vijon transformimin e tij akademik dhe institucional, duke synuar forcimin e cilësisë së arsimit, zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe lidhjen më të ngushtë të studimeve me nevojat e tregut të punës.

Lexoni artikullin e plotë në median italiane Corriere Italico:
https://www.corriereitalico.it/universita-agraria-di-tirana/

UBT prezanton kontributin në kërkimin shkencor dhe politikat për parandalimin e rezistencës antimikrobike

Universiteti Bujqësor i Tiranës priti në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare ekipin e DG SANTE, ECDC dhe EFSA, në kuadër të vizitës monitoruese në Shqipëri për rezistencën antimikrobike (AMR) dhe qasjen “Një Shëndet”.

Zv. Rektorja për Shkencën dhe Projektet, Prof. Dr. Erinda Lika, prezantoi aktivitetet kërkimore, nismat për ndërgjegjësimin dhe komunikimin shkencor, si dhe bashkëpunimin e UBT-së me institucionet kombëtare në adresimin e rezistencës antimikrobike.

Në fokus të prezantimit ishin projektet shkencore, zhvillimi i infrastrukturës laboratorike dhe kërkimore, si dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve të specializuara dhe bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar. Prof. Dr. Erinda Lika theksoi rëndësinë e shndërrimit të rezultateve kërkimore në rekomandime konkrete, masa parandaluese dhe politika të bazuara në evidencë shkencore, duke forcuar lidhjen mes kërkimit, institucioneve dhe vendimmarrjes.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjithashtu ndërgjegjësimit dhe transferimit të njohurive shkencore te profesionistët dhe komuniteti, në mbështetje të qasjes “Një Shëndet”, e cila ndërthur shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit.

Në vijim, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, Prof. Dr. Rezart Postoli, prezantoi integrimin e rezistencës antimikrobike në programet universitare dhe pasuniversitare, ndërsa Ervin Resuli, President i Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar, theksoi rolin e mjekëve veterinerë në përdorimin racional të antibiotikëve dhe parandalimin e përhapjes së rezistencës.

Vizita evidentoi kontributin e UBT-së në kërkimin shkencor, edukimin dhe bashkëpunimin institucional për parandalimin dhe kontrollin e rezistencës antimikrobike, si dhe rëndësinë e qasjes së koordinuar “Një Shëndet”.

Lexo më shumë...

UBT mirëpret në një takim Ambasadorin e Spanjës

Ishte kënaqësi për UBT të prisnim Sh.T.Z. Gabriel Cremades, Ambasador i Spanjës në Shqipëri, në një takim të fokusuar në forcimin e bashkëpunimit në arsim, kërkim shkencor dhe inovacion.

Në qendër të diskutimit ishte konferenca ndërkombëtare “WATER 2030”, e cila do të zhvillohet në Tiranë më 3 nëntor 2026, nën patronazhin e Ambasadës së Spanjës në Shqipëri dhe me UBT-në si institucionin akademik udhëheqës.

Konferenca do të bashkojë UBT, CIHEAM Zaragoza, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, KIT, BOKU University Vienna, GEO-WB6 dhe FAO Albania, me fokus modernizimin e menaxhimit të ujit dhe sistemeve të ujitjes, inovacionin dhe përafrimin me standardet europiane.

Nga përvoja europiane te zgjidhjet shqiptare – drejt Albania Water 2030.

Lexo më shumë...

Lumi Ishëm – Burim i Jetës: Shkenca dhe komuniteti bashkë për mbrojtjen e ujit

Në Fushë-Krujë, më 16 tetor, u zhvillua workshop-i **"Lumi Ishëm – Burim i Jetës"**, në kuadër të projektit ndërkombëtar AMORE-AL, ku u prezantuan rezultatet e monitorimit dyvjeçar të ndotjes në basenin e lumit Ishëm dhe masat e nevojshme për përmirësimin e situatës mjedisore.

Koordinatori i projektit, Prof. Dr. Seit Shallari, prezantoi objektivat dhe ecurinë e tij, ndërsa doktorantët Fatos Huqi, Vjola Bakillari dhe Xhulio Sema paraqitën gjetjet kryesore mbi burimet e ndotjes dhe zonat prioritare për ndërhyrje. Diskutimet u drejtuan nga Prof. As. Dr. Romina Koto, ndërsa Prof. Dr. Ferdi Brahushi trajtoi menaxhimin e rrezikut dhe masat për reduktimin e ndotjes.

Aktiviteti bashkoi përfaqësues të institucioneve, pushtetit vendor, komunitetit dhe organizatave mjedisore për të diskutuar mbrojtjen e lumit, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe përfshirjen e qytetarëve në monitorimin mjedisor. Projekti AMORE-AL synon të kthejë kërkimin shkencor në zgjidhje konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. **Lexo më shumë...**

GRATË NË SHKENCË – KONTRIBUTI I TYRE NË KËRKIMIN SHKENCOR DHE MBROJTJEN E BURIMEVE UJORE I

Në kuadër të projektit ndërkombëtar AMORE-AL, u zhvillua workshop-i "Women's Day in Water Science – Dita e Gruas në Shkencën e Ujit", me fokus promovimin e rolit të grave në kërkimin shkencor, monitorimin e cilësisë së ujërave dhe mbrojtjen e mjedisit.
Aktiviteti trajtoi ndotjen e ujërave në pellgun e lumit Ishëm, analizat laboratorike dhe vlerësimin e ndotësve, duke vlerësuar kontributin e specialisteve dhe studiuesve në realizimin e kërkimeve shkencore.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e nxitjes së vajzave dhe grave të reja për të ndjekur karriera në shkencë, si dhe e forcimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit akademik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në Shqipëri. **Lexo më shumë...**

UBT akordon pesë tituj të rinj akademikë “Profesor”

Universiteti Bujqësor i Tiranës i shton komunitetit akademik pesë tituj të rinj “Profesor”, të akorduar për **Fatmir Gurin, Anila Boshnjakun, Ina Pagrinë, Dori Risilian dhe Orkida Ilollarin**. Më 30 shtator 2026, Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik vlerësoi veprimtarinë akademike dhe kërkimore të kandidatëve, duke vendosur unanimisht akordimin e titullit.

Punimet e prezantuara trajtuan tema me rëndësi për zhvillimin e vendit, përfshirë transformimet rurale dhe përdorimin e tokës në Shqipëri, si dhe ndikimin e karakteristikave të Liqenit të Ohrit në vlerën ekonomike të pronave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave turistike.

Kjo arritje përfaqëson një vlerësim të kontributit shumëvjeçar të profesorëve në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke forcuar angazhimin e UBT-së për promovimin e ekselencës akademike dhe zhvillimin e dijes në shërbim të shoqërisë. **Lexo më shumë...**

Absorbimi i metaleve të rënda, doktoraturë në UBT në bashkëpunim me BOKU

Universiteti Bujqësor i Tiranës shënon një tjetër arritje në kërkimin shkencor me mbrojtjen e doktoraturës me notën "Shkëlqyeshëm" nga Dr. Teuta Bushi, asistente lektore në Departamentin e Fizikës, Fakulteti i Shkencave Pyjore. Studimi i saj, i realizuar në kuadër të Programit të Doktoraturës në Shkencat Mjedisore, nën udhëheqjen e Prof. Dr. Aida Bani, trajton përdorimin e argjilave për reduktimin e ndotjes së tokave nga metalet e rënda. Rezultatet evidentuan potencialin e argjilave të pasura me smektit për të kufizuar disponueshmërinë e nikelit për bimët, duke ofruar perspektiva për rehabilitimin e tokave të ndotura përmes zgjidhjeve natyrore dhe të qëndrueshme. Një kontribut të rëndësishëm në këtë kërkim dha edhe bashkëpunimi me Prof. Franz Ottner nga Universiteti BOKU i Vjenës, në kuadër të partneritetit strategjik UBT–BOKU.

Kjo arritje dëshmon rolin e UBT-së në zhvillimin e kërkimit shkencor, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe krijimin e zgjidhjeve inovative për sfidat mjedisore. Universiteti i uron Dr. Teuta Bushit suksese të mëtejshme në karrierën e saj akademike dhe shkencore. **Lexo më shumë...**